

Gjuha e folur dhe e shkruar

1. Nga të folurit tek shkrimi.
2. Koncepti i tekstit nga ana gjuhësore.
3. Disa nga kërkesat themelore kryesore të analizës së tekstit.
4. Konteksti dhe polisemia.
5. Domethënia horizontale dhe domethënia pingule.

1. Nga të folurit tek shkrimi

Po ta shohim në tërësinë e saj gjuhën e sotme shqipe si një sistem variantesh, mund të themi se trajta e saj e shkruar, që ka edhe zbatim gojor pothuajse të njëjtë, qëndron në krye. Trajta e shkruar e udhëheq sot gjithë procesin e njësimit dhe të përparimit gjuhësor, jo vetëm brenda territoreve të Republikës së Shqipërisë, por edhe në diasporat shqiptare, sepse pikërisht në këtë trajtë gjuha letrare ka arritur njësimin më të plotë dhe prandaj ajo është bërë sot “**emëruesi i përbashkët**” i njësisë njëformëshë të gjuhës të gjithë kombit shqiptar. Krahas trajtës së shkruar, gjuha letrare shqipe ka edhe trajtën e folur, që përfshin edhe gjuhën e ligjëratave të pashkruara dhe ligjërimin letrar-bisedor të njerëzve më të shkolluar.

Historikisht, më e lashtë është gjuha në **trajtën e saj të folur**, e cila ka lindur së bashku me mendimin, si një veshje materiale e këtij të fundit. Pas një periudhe relativisht të gjatë të ekzistencës së gjuhës në trajtën e saj të folur, për nevoja të komunikimit më të gjerë dhe veçanarisht për të bërë të mundur ruajtjen dhe transmetimin e mendimeve e të përvojës në plan kohor, d.m.th. nga brezat e vjetër tek të rinjtë, nga një epokë në tjetrën, gjenia njerëzore shpiki edhe një trajtë të dytë të gjuhës, **trajtën e saj të shkruar**. Këto dy trajta të gjuhës kanë shumë anë të përbashkëta, të cilat duhet të dihen.

Mbi bazën e gjuhës së folur ngrihet një aftësi plotësuese, por shumë e rëndësishme e komunikimit të njeriut: **shkrimi dhe leximi**. Aftësia e të shkruarit lind mbi bazën e të folurit, por, me kohë, zhvillohet aq shumë, saqë në një farë mase ia kalon atij.

Gjuha e shkruar ose paraqitja grafike, në shumicën e rasteve nuk është një transkodifikim i thjeshtë i të folurit të shkruar. Natyrisht, në parim, çdo gjë që flitet mund të paraqitet edhe me shkrim (grafikisht) ose anasjelltas, por është fakt i mirënjohur që nuk flasim ashtu siç shkruajmë p.sh. leksioni që mban një profesor pranë studentëve të tij, fjalimet e ndryshme publike të personaliteteve të shquara politike, paraqitja e ligjeve, dekreteve, aktet gjuhësore etj, janë në **fakt trajta të dyfishta (ambigue)** ku të folurit ndërtohet mbi bazën e të shkruarit. Në komunikime të tilla, mbi bazën e fjalës së shkruar, gjuha e folur fiton struktura të reja shprehjeje, të cilat pasurojnë sistemin e gjuhës, prandaj edhe duhen studiuar me vëmendje të posaçme. Por, trajta të tilla nuk duhet të përzihen me gjuhën e folur të mirfilltë. Kur themi gjuhë e folur, në radhë të parë, kemi parasysh dialogun, bisedën me dikë d.m.th. komunikimi që realizohet dhe varet nga një situatë e caktuar.

Dhe pikërisht, është situata e ligjërit ajo që e motivon bisedën e gjallë, që i jep asaj domethënie të plotë.

Mënyra e analizës së strukturës gramatikore të gjuhës së folur, në krahasim me atë të gjuhës së shkruar, bën të mundur të zbulohen dallime të ndjeshme p. sh. kur ulemi të shkruajmë edhe një letër të thjeshtë, drejtuar një të afërmi, shprehja merr një drejtim tjetër, të ndryshën nga ai i gjuhës së folur. Të njëjtën përmbajtje, p.sh. kërkesën për t'u regjistruar në Universitetin e Podgoricës e paraqesim ndryshe me shkrim dhe ndryshe nëse paraqitemi në një zyrë dhe të kërkojmë me gojë që të regjistrohemi. Këta shembuj tregojnë se ka dallime të ndjeshme strukturore midis gjuhës së folur të përditshme, nga një anë, dhe gjuhës së shkruar nga ana tjetër. Por midis tyre ka edhe pika të përbashkëta. Kështu gjuha e folur i zhvillon elementet e kodit të saj në kohë, kurse në gjuhën e shkruar kjo kohë realizohet në formë drejtvizore (lineare), por që të dyja këto kode kanë njëjtësi (identitet) midis tyre. Këtë njëjtësi duhet ta kuptojmë në mënyrë të tillë: elementet që përbëjnë shkrimin janë shenjat grafike (shkronjat) dhe shenjat e pikësimit; kurse gjuha e folur përbëhet nga shenja gjuhësore të nyjtuara me zë. Të dyja sistemet, të folurit dhe të shkruarit, përputhen në përmbajtje identike: transmetimi i përvojës njerëzore të përgjithshme. Ndërkaq, ato dallohen nga fakti që për shkrimin shërbejnë elementet grafike, kurse për të folurit elementet zanore (vokale). Uniteti grafik, si për shkrimin, ashtu edhe për leximin, nuk është shkrirja e vetmuar, por tërësia rrokjesore dhe paraqitet grafikisht me shumë shkronja. Çdo njësi grafike ka lidhje të qëndrueshme dhe specifike me njësinë fonologjike që zbulohet nga konteksti. Pra, përvetësimi i shkrimit dhe i leximit varet nga përvetësimi i gjuhës së folur.

Për shumë kohë njerëzimi ka pasur vetëm trajtën e folur të gjuhës. Në vende të ndryshme shkrimi nuk është shpikur në të njëjtën kohë, prandaj ka pasur realizime grafike nga më të ndryshmet, siç janë shkrimet ideografike, piktografike etj.

Por mund të ndodh edhe në ditët e sotme që një fëmijë, apo grup fëmijësh, po të mos dërgohen në shkollë e po të mos bëhet punë me ta për të mësuar shkrim e këndim, mund të mbeten analfabetë, pra, ata, do të dinin të flisnin shqip, por nuk do të njihnin trajtën e saj të shkruar.

Gjuha e folur dallohen qartë në kushtet e funksionimit të tyre:

- a. Gjuha e folur u drejtohet një numri të kufizuar personash, kurse gjuha e shkruar u drejtohet shumë personave ose mbarë kombit.
- b. Në gjuhën e folur zotruet është dialogu apo ligjërimi i mbërthyer, ndërpersonal, kurse në gjuhën e shkruar formë zotëruese është monologu. Shkrimtari, gazetari shkruan dhe atë që publikon apo boton ai mund ta lexojnë qindra e mijëra veta.
- c. Në gjuhën e folur temat e bisedës zakonisht janë të thjeshta; ato i përkasin jetës së përditshme dhe plotësohen nga gjestet, mimika, intonacioni etj. Përkundrazi, në gjuhën e shkruar temat apo subjektet janë të rëndësishme, të ndërlikuara, shpesh me përmbajtje politike, filozofike, shoqërore, shkencore etj., pra, me karakter publik e zyrtar me rëndësi.

- d. Në gjuhën e folur ata që hyjnë në bisedë, si rregull, janë në afërsi të njëri-tjetrit, pra, kanë takim a kontakt të drejtpërdrejtë, kurse në gjuhën e shkruar, si rregull, takimi midis atij, që shkruan dhe lexuesve të tij nuk është i drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se aty mungojnë ndërhyrjet gojore apo elementet plotësuese. Gjithçka mbyllet brenda letrës së shkruar me fjalë, fjali, shenjat e pikësimit.

Njohja e këtyre kushteve të funksionimit të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar është me rëndësi, në radhë të parë për përcaktimin e karakteristikave themelore të gjuhës së folur në dallim nga stilet e shkruara.

Situata mund të jetë e tillë:

- a. Gjuha e folur ka karakter spontan dhe të zhdërvjellët, me karakter zakonisht joformal, kurse stilet e shkruara kanë karakter formal, zyrtar.
- b. Anë zotëruese e kumtimit në gjuhën e folur është ndjenja, emocioni, afekti; kurse në stilet e shkruara anë zotëruese është logjika, paraqitja e saktë dhe e menduar mirë. Pra, në një farë mënyre kemi një kundërvënie sipas dy kaheve: **ndjenjë-arsye**.
- c. Në gjuhën e folur nuk shquan ndonjë përkujdesje paraprake e folësit për të bërë paraqitjen dhe renditjen logjike të idesë së thënies. Përkundrazi, për stilet e shkruara ka gjithmonë mëtim për saktësi dhe përpikmëri, synohet sa më tepër shprehja e rrjedhshme dhe renditja logjike e ideve dhe e mendimeve a fakteve.

2. Koncepti i teksit nga ana gjuhësore.

Ç’kuptojmë me tekst nga ana gjuhësore? Fjala tekst është një fjalë më kuptim të gjerë, të hapët e të pakufizuar. Tekst mund të quajmë çdo thënie që përbëhet nga një fjalë e vetme e deri tek një vepër e plotë. Teksti është një strukturë hierarkike, d.m.th. sekuencat, si përbërësit e tij, janë të lidhura sipas një shkalle hierarkike që fillon me elementin më të vogël për të realizuar njësinë më të madhe të komunikimit-Tekstin.

Që teksti të jetë i plotë duhet të ngërthejë:

- a) atë çka shkruarit (apo folësit) i intereson të komunikojë;
- b) atë çka marrësit (lexuesit apo dëgjuesit) i shërben për të interpretuar komunikimin
- c) informacioni komunikues jepet në një formë të caktuar duke bërë disa zgjedhje gjuhësore që respektojnë rregullat e llojit të cilit i përket teksti.

Përzgjedhja dhe kombinimi i njësive të tekstit janë dy elemente të rëndësishme, që mundësojnë realizimin e tekstit të plotë.

Siç thamë teksti mund të përbëhet edhe një fjalë e vetme p.sh mbi një tabelë është shkruar “**LIBRARI**”. Këto 7 shkronja përbëjnë një fjalë dhe në të njëjtën kohë formojnë një tekst, sepse: 1. komunikon në mënyrë të plotë dhe të njësishtme atë çka pronarit të dyqanit i intereson, pra, llojin e produktit që tregon; 2. i jep lexuesit informacionin e nevojshëm për të vendosur nëse dëshiron të hyjë apo jo (dëshiron apo jo të blejë një libër); 3. respekton rregullat e shkrimit për tabelat

Në skenë dhe në ekran fjala tekst përdoret me kuptimin e dialogut të personazheve të dramës.

Kur flasim për analizën e tekstit, kuptohet, është fjala gjithmonë për tekste pak a shumë të plota.

3. Disa nga kërkesat themelore kryesore të analizës së tekstit

Kërkesat themelore për analizën e tekstit të një veprë letrare janë:

- a. Të studiohet e të shqyrtohet mirë teksti në mënyrë që të zbulohet përmbajtja e tij në dy rrafshet: *në rrafshin horizontal* apo në kuptimin e domethënien që duket qartë, dhe *në rrafshin pingul*, d.m.th. duke hyrë në thellësi në kuptimet nëntekstore të veprës në tërësi, të marrë në analizë në veçanti.
- b. Të njihet *botëkuptimi, psikologjia dhe kultura dhe prirjet shpirtërore të autorit*, të cilat, gjithashtu, mund të dalin më të plota e të qarta, po t'i vendosim në kuadrin e gjerë të psikologjisë e të mendësisë shoqërore të kohës që ai i përket.
- c. Të njihen mjetet shprehëse gjuhësore, të zbulohet mekanizmi i përdorimit të tyre, të vlerësohen nga pikëpamja e caktuar të lejueshëm të përdorimit të tyre origjinal, vetjak nga autori, si dhe nga pikëpamja e shkallës së pajtueshmërisë së tyre me përmbajtjen e dhënë, me ligjësitë e prirjet e zhvillimit të gjuhës. Shumë i rëndësishëm është elementi i analizës së tekstit në veprat me temë nga e kaluara historike, në mënyrë që nëpërmjet saj, të vihet një emërues i përbashkët të natyrshëm norma gjuhësore e sotme me trajtat dhe fjalët tashmë të vjetëruara, jonormative, që përdoren aty me vlerë ngjyrimi dhe individualizimi të epokës përkatëse.
- d. Të njihen procedurat e analizës stilistike dhe të analizës gjuhësore të mirfilltë të tekstit dhe të përcaktohet shkalla e përparësisë dhe e rendit të tyre. Analiza stilistike është vetëm një pjesë e analizës së tekstit. Analiza stilistike nuk kërkon përfatesat e veçanta, por parimin drejtues të organizimit të shprehjes së një veprë letrare, duke vënë në dukje jo thjesht vlerat stilistike, por funksionimin e tyre. Qëllimi kësaj analize është të depërtojë më thellë në përmbajtjen dhe në mënyrat e shprehjes së saj, të nxjerrë në dukje strukturën e brendshme, të kalojë nga sipërfaqja në brendësi për ta kuptuar më mirë.

Analiza e tekstit është shumë e gjerë dhe ka synime shumë më të gjera. Ajo kërkon edhe zbulimin e vlerave të mjeteve të shprehjes gjuhësore, të përftesave stilistike e të stilimeve të veçanta, të figurave gjuhësore e të figurave letrare, zbulimin e mundësive të tjera të shprehjes së të njëjtës përmbajtje mendimore ose emocionale, motivimin e njërës ose të tjetrës zgjidhje gjuhësore të shprehjes së një përmbajtjeje të caktuar.

4. Konteksti dhe polisemia

Në gjuhë ndodh dendur që fjalët me kalimin e kohës të fitojnë kuptime të reja, të ndërrojnë vështrim, ta zgjerojnë ose ta ngushtojnë hapësirën e kuptimit të tyre fillestar. Kështu p.sh. **thur** do të thotë: 1. thur gardhin; 2. *thur çorape*; 3. *thur intriga* etj., **burim**: 1. *krua*, *burim uji*; 2. *bazim*, *faktim me dokumentacion*, *dokument historik*, 3. *qendër*, *vatër* etj.

Kjo aftësi e fjalëve për të marrë më shumë se një kuptim, në varësi të lidhjes me fjalë të tjera, quhet **polisemi**, *që do të thotë shumë kuptime*. Duke qenë se kjo dukuri është një trajtë karakteristike e gjuhës, aty konteksti merr një rëndësi të veçantë dhe del në rolin e aktualizuesit semantik. Por, megjithatë, konteksti nuk duhet ekzagjeruar, sepse nganjëherë atij i njihet pa të drejtë aftësia e mbartjes së kuptimit të fjalës. E vërteta është se, sado e madhe që të jetë rëndësia e kontekstit, ai nuk është kurrë absolut. Fjala, si njësi leksikore, është, para së gjithash, një njësi semantike. Edhe kur merret e izoluar, e shkëputur nga konteksti, në fjalë shquan një kuptim themelor të saj. Në këtë mënyrë kontekstit i mbetet vetëm të realizojë, të aktualizojë këtë ose atë kuptim të fjalës. Kështu, togfjalëshi **ha bukë** ka kuptimin e të ushqyerit. Në kontekste të caktuara ky togfjalësh mund të ketë edhe një kuptim tjetër, p.sh. *kjo që thua ti nuk ha bukë "nuk shkon" ose "ai ha bukë veç" "është shumë i mirë"*.

Në fakt, një numër i mirë fjalësh me kuptime, janë prodhime të mjedisit (kufizim krahinor, historik ose shoqëror) p.sh. **qumësht-i** dhe **kjumësht-i** e kumësht-i lidhen në thelb me shqipen e lashtë **klumësht**, që e gjejmë tek Buzuku ose edhe sot në disa të folme, si ato të çamërisë, tek arbëreshët e Italisë etj. Por, në shumë të folme të Veriut, **qumësht** nuk ka atë kuptim që ka kjo fjalë në gjuhën letrare. **Kjumsht** (në Malësi të Madhe), **kumsht** (Kosovë), do të thotë **"hirrë e zier dhe e zënë më tharm si kosi"**, kurse për fjalën qumësht atje përdoret **tamël-i**.

Të tilla në të folmet e shqipes janë të shumta dhe quhen dialektalizma semantike ose fjalë me kuptime territoriale të dallueshme.

Fjala mund të realizojë një kuptim të veçantë edhe sipas mjedisit shoqëror dhe profesional ku është përdorur. Kështu fjala **operacion** merr një vlerë të dallueshme në gojën e një mjeku, të një ushtaraku dhe të një financieri.

Në kundërshtim me fjalët polisemike, që përbëjnë pjesën më të madhe të leksikut, fjalët me kuptim të vetëm (*monosemike*) janë relativisht të pakta.

Një vend të veçantë zënë **termat** (*fjalë ose togfjalësja që shprehin koncepte shkencore ose speciale*). Termi me shumë kuptime është një mjet i papërshtatshëm për komunikim. Termat kanë si karakteristikë mungesën e çdo nuance afektive, pra termat nuk shërbejnë për të shprehur emocione.

5. Domethënia horizontale dhe domethënia pingule

Çdo tekst mund të ketë si **domethënie horizontale** ashtu edhe **domethënie pingule**, në thellësi p.sh. në fjalinë *“Iku vapa me gushtin”*, domethënia horizontale del nga kuptimet e fjalëve që e përbëjnë. Mund të themi se domethënia horizontale është informacioni i drejtpërdrejtë që na e japin këto fjali: *“Bashkë me stinën e ngrohtë iku dhe vapa dhe, për pasojë, një stinë e re po vjen”*. Mirëpo, një fjali e tillë, në varësi të rrethanave jashtëgjuhësore në të cilat përdoret, mund të ketë edhe ndonjë kuptim tjetër, një kuptim që qëndron i mbuluar nën tekstin apo në atë që e quajmë domethënie pingule. Veçse, domethënia pingule zbulohet me vështirësi të shkallëve të ndryshme, ajo nuk është një përmbajtje e shkruar, por përmbajtje e nënëkuptuar, rrjedhimi që del nga domethënia horizontale apo ajo që quhet zakonisht **nënteksti**.

I njëjti tekst mund të ketë domethënie të ndryshme dhe, për pasojë, të nxirren më shumë se një domethënie pingule. Në gojën e një të moshuari ajo mund të ketë domethënien: *“U mplaka, iku rinia ime bashkë me vitet që kalova”*.

Për të zbuluar domethënien pingule të tekstit, është me rëndësi të veçantë që ai të vendoset në një kontekst më të gjerë, në situatën e ligjërit, për të zbuluar atë që në gjuhën e përditshme e sidomos në të folurit e atyre që merren me komentimin letrar të teksteve të ndryshme shprehet me pyetjet: *“Ku e ka fjalën autori?”*. Natyrisht, për të zbuluar nëntekstin duhen pasur mirë parasysh edhe ligjëritet e stilet, sepse dihet që në disa prej tyre mbizotërojnë tekstet me domethënie horizontale, p.sh. në stilin tekniko-shkencor, në stilin zyrtar, kurse në gjuhën e letërsisë artistike mbizotërojnë tekstet me domethënie pingule. I njëjti tekst nga veta të ndryshme, sipas interpretimit që i bëjnë, mund të dalë me domethënie pingule të ndryshme.

Nënteksti apo domethënia pingule shpreh mirë edhe veçoritë e çdo autori në organizimin e tekstit, mjeshtërinë e tij, shkallën e abstraksionit e të figurshmërisë, synimet ideoartistike, mënyrën e të menduarit e të arsyetuarit, thellësinë e njohjes së vlerave e të mjeteve të shprehjes. Detyrë e parë e analizës së tekstit është të zbulojë domethënien horizontale dhe pingule të tekstit, pastaj të depërtojë në shkallën e mënyrën e bashkimit e të ndërthurjes së tyre, për të ndriçuar domethënien e përgjithshme të tekstit të dhënë.